

VENDIM
Nr. 242, datë 30.9.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “GSA ENERGY” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2478/1 prot., datë 23.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GSA Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “GSA Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2478 prot., datë 18.9.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a” dhe “c”; si dhe për pikën 2.4, gjerat “a” dhe “b”.

- Shoqëria duhet të plotësojë më tej informacionin/dokumentacionin si vijon:

Neni 9. Formatit dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “c”: shoqëria duhet të depozitojë informacion në lidhje me stafin teknik që është aktualisht efektiv në strukturën e saj.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “b”: shoqëria duhet të dokumentojë mbështetjen financiare për të garantuar ushtrimin e të paktën 1 (një) muaji të veprimtarisë.

Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike

- germa “b”: shoqëria ka referuar dy sisteme IT-je, ndaj duhet të sqarojë se cilin sistem do të përdorë për realizimin e procesit të faturimit të klientëve;

- germa “c”: shoqëria duhet të sqarojë se si parashikon disponimin e zyrave për pjesën e mbetur të periudhës së licencimit;

- germa “d”: shoqëria duhet të japë informacion mbi mënyrën e realizimit të matjes për klientët.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GSA Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “GSA Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti